

KONTRATË SHITJE

Sot më datë 26.02.2024 palët pjesmarrëse kanë rënë dakort për lidhjen e kontratës së mëposhtme”

PALËT PJESMARRËSE NË KONTRATË :

- **Z. Taulant Musabelliu**, shtetas shqiptar, lindur më 21.10.1980 në Tërrovë, Skrapar, Shqipëri dhe banues në Tiranë, i identifikuar me numër personal I01021087U, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; (Shitësi)
- **Shoqëria "Ngop Media" Shpk**, shoqëri shqiptare e regjistruar në QKB me nipt M02402008K ,me administrator Taulant Musabelliu me adres kryesore Tirane Tirane TIRANË Njesia Bashkiake Nr. 5, Rruga Abdyl Frasheri, EGT Tower, Kati 6 ; (Shitësi)
- **Znj. Erjola Leka**, shtetase shqiptare, lindur më 30.08.1987 në Dibër, Shqipëri dhe banuese në Tiranë, e identifikuar me numër personal I75830055V, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar; (Shitësi)
- **Z. Donald Rama**, shtetas shqiptar, lindur më 02.05.1982 në Fier, Shqipëri dhe banues në Tiranë, i identifikuar me numër personal I20502028V, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar; (Shitësi)
- **Z. Danier Shkurti**, shtetas shqiptar, me zotësi të plotë Jurdike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I30728065C, lindur më Tirane, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri (Blerësi)
- **Z. Rubin Beqo** shtetas shqiptar, me zotësi të plotë Jurdike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi I50213047H , lindur më Tirane, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Blerësi)
- **Z. Saimir Kolanecl** shtetas shqiptar, me zotësi të plotë Jurdike për të vepruar dhe me numer personal identifikimi H90213042Q , lindur më Tirane, Shqipëri me adresë banimi Tiranë, Shqipëri. (Blerësi)

Neni 1

OBJEKTI I KONTRATËS

Objekti i kësaj kontrate është shitja e kuotave zotëruese nga Taulant Musabelliu, Shoqëria Ngop Media, Donald Rama dhe Erjola Leka te cilet përfaqësojnë 100% të kapitalit të shoqërisë “Noquit” me numër unik (NUIS) M21815033A, me adresë Tirane Tirane Rruga Abdyl Frasheri,EGT Tower, Kati 6, Hyrja 14, 1019 Tirane.



- Shitjen e kuotës zotëruese nga ortakët Taulant Musabelliu, Shoqëria Ngop Media, Donald Rama dhe Erjola Leka 100% të kuotave të tyre në total; tek Danier Shkurti 40% të kuotave Rubin Beqo 40% të kuotave dhe Saimir Kolaneci 20 % të kuotave.

Neni 2

Emimi

Emimi i shitjes së 4 (kater) kuote e cila përfaqëson 100 % të kapitali të shoqërisë "Noquit" është 100 000 lek .

Neni 3

Afati i pagimit të emimit

Pagimi i emimit do të kryhet pas nënshkrimit të kësaj kontrate.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e shitesit

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë nga blerësi pagimin e emimit në mënyrën dhe afatin e parashikuar në këtë kontratë.
2. Shitësi është i detyruar t'i dorëzojë blerësit të gjithë dokumentacionit që shënon të drejtën e pronësisë dhe që janë të nevojshme për kalimin e saj.
3. Shitësi duhet të garantojë blerësin për gezimin e qetë të kuotave nga cdo e drejtë pronësie të personave të tretë. Shitësi është i detyruar të marrë pjesë në gjykim në mbështetje të blerësit nëse ai thirret prej tij, për ta garantuar ndaj pretendimeve të personave të tretë, mbi kuotat objekt i kontrates.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrat e blerësit

The bottom of the page contains several handwritten signatures in blue ink, likely representing the parties involved in the contract.

1. Blerësi ka të drejtë të kërkojë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e shitësit mbi kuotat, objekt kontrate nga shitësi nga e nesërmeja e hyrjes në fuqi të kësaj kontrate.
2. Blerësi është i detyruar të marrë në zotërim vendin ku shoqëria ka qendërën e ushtrimit të aktivitetit

Neni 6

Zgjidhja e kontratës

1. Shitësi ka të drejtë të kërkojë të zgjidhe kontraten kur:

- a) blerësi nuk paguan emimin.
- b) blerësi nuk merr në dorëzim objektin ku shoqëria ushtron aktivitetin , brenda 15 ditëve nga afati shtesë i caktuar nga shitësi;
- c) blerësi nuk merr në dorëzim dokumentat e pronësisë së kuotave

2. Blerësi ka të drejtë të kërkojë zgjidhjen e kontratës kur:

- a) shitësi nuk dorëzon dokumentat e pronësisë së kuotave
- b) shitësi nuk dorëzon objektin e ushtrimit të aktivitetit të shoqërisë, objekt kontrate brenda afatit shtesë 10 ditor, të caktuar nga blerësi ;
- b) shitësi deklaron brenda afatit 10 ditor se nuk do të dorëzojë dokumentacioni dhe objektin e ushtrimit të aktivitetit;

Neni 7

Pasojat e zgjidhjes së kontratës

1. Shitësi me zgjidhjen e kontratës duhet t'i kthejë pagesat e bëra blerësit, dhe gëzon të drejtën për shpërblimin e dëmit .

Neni 8

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve:



Në rast mosmarrveshje midis tyre palët do t'i zgjidhin me mirëkuptim, dhe vetëm kur një gjë e tillë është e pamundur ato do t'i drejtohen gjykatës së "Rrethit Gjyqësor Tiranë".

Neni 9

Shpenzimet për lidhjen e kontratës

Shpenzimet për lidhjen e kësaj kontrate i ngarkohen të dyja palëve përkatësisht.

Neni 10

Momenti i kalimit të pronësisë dhe Hyrja në fuqi

Kuotat zotëruese të ortakeve Taulant Musabelliu, Shoqëria Ngop Media, Donald Rama dhe Erjola Leka të shoqërinë "Noquit" Shpk në datën 26.02.2024 kalojnë në pronësi të, Danier Shkurti 40% të kuotave me vlerë 40 000 all, Rubin Beqo 40% të kuotave me vlerë 40 000 all dhe Saimir Kolaneci 20 % të kuotave me vlerë 20 000 all.

Neni 11

Hartimi i kontratës

Kjo kontratë u hartua në 2 (dy)kopje nga një për secilën palë.

PALET KONTRAKTUESE

SHITËSIT :

Taulant Musabelliu

Shoqëria Ngop Media

Donald Rama

Erjola Leka

BLERESI :

Danier Shkurti

Rubin Beqo

Saimir Kolaneci